

Udhëzues  
**ÇFARË KËRKOHET PËR  
TË REGJISTRUAR**

**NJË BIZNES  
E-COMMERCE**

**NË KOSOVË?**

[ecommerce4all.eu](http://ecommerce4all.eu)

2022

	<b>RRETH PLATFORMËS</b>	<b>1</b>
<b>I.</b>	<b>HAPAT E KRIJIMIT TË NJË BIZNESI E-COMMERCE</b>	<b>2</b>
	BËNI NJË ANALIZË TË TREGUT	<b>3</b>
	KRIJONI NJË PLAN BIZNESI	<b>3</b>
	KRIJIMI I NJË SHOQËRIE TË E-TREGTISË	<b>5</b>
	THEMELIMI I KOMPANISË	<b>4</b>
	ZGJEDHJA DHE ZHVILLIMI I NJË ZGJIDHJEJE SOFTUERIKE	<b>4</b>
	INTEGRIMI I PROCESORIT TË PAGESAVE	<b>5</b>

# RRETH PLATFORMËS ecommerce4all.eu

Platforma ecommerce4all.eu është një qendër burimesh dhe informacioni mbi aspektet kryesore të tregtisë elektronike për të gjitha tregjet e CEFTA-s (Maqedonia e Veriut, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Shqipëria, Kosova, Mali i Zi dhe Moldavia). Platforma e internetit përbëhet nga të dhëna dhe burime përkatëse të tregtisë elektronike, duke përfshirë të dhënat bazë të tregtisë elektronike, grafikët ndërveprues dhe të dhënat mbi zhvillimin e tregut të tregtisë elektronike në CEFTA, si dhe të dhëna për aspektet kryesore të të bërit biznes në tregtinë elektronike.

Të dhënat mbi aspektet kryesore të të bërit biznes në tregtinë elektronike do të strukturohen në katër module: legjislacioni për tregtinë elektronike, pagesa, shpërndarja dhe tregimet e suksesit të tregtisë elektronike në të gjitha tregjet e CEFTA-s. Secili prej këtyre moduleve do të përmbajë informacione përkatëse të tregut të CEFTA-s, udhëzime, manuale, dokumente të lidhura me temën dhe video prezantime. Përveç katër moduleve, është zhvilluar një modul i pestë shtesë që synon të paraqesë gjendjen e tregtisë elektronike përmes statistikave dhe të dhënave për zhvillimin e tregut të tregtisë elektronike (grafikë interaktive e gjendjes së tregtisë elektronike në secilin treg dhe krahasimet p.sh. klientëve, kartat e pagesave, aftësitë digjitale, indeksi i gatishmërisë për tregtinë elektronike UNCTAD B2C dhe të dhëna të tjera përkatëse të Eurostat-it). Të gjitha të dhënat do të paraqiten si në gjuhën lokale të secilit prej tregjeve të CEFTA-s ashtu edhe në gjuhën angleze.

Zhvillimi i platformës së internetit mbështetet nga projekti i Fondit të Hapur Rajonal për Evropën Juglindore - Tregtia e Jashtme, i zbatuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH në emër të Bashkimit Evropian dhe Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).

\*Ky përcaktim nuk sjell asnjë pasojë në qëndrimet mbi statusin dhe është në përputhje me RKSKB 1244 ( Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara) dhe Opinionin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

# HAPAT E KRIJIMIT TË NJË BIZNESI E-COMMERCE

QË TË FILLOJË FUNKSIONIMIN DHE KRYERJEN E TREGTISË ELEKTRONIKE, SË PARI DUHET TË REGJISTROHENI SI SHOQËRI TREGTARE NË REGJISTRIN QENDROR E-TREGTARI (PERSON JURIDIK).


Kompanitë që janë të regjistruara në Agjensionin e Regjistrimit të Biznesit Kosovar (ARBK) dhe operojnë si tregtarë "offline", por duan të zgjerojnë mënyrën e shitjes së mallrave dhe shërbimeve, nuk kanë nevojë të reregjistrohen.

Ashtu si fillimi i çdo kompanie tjetër, procesi i regjistrimit të një kompanie të tregtisë elektronike nuk është i ndryshëm. Për të ngritur biznesin tuaj online, duhet të ndiqni disa hapa.

## HAPI 1: BËNI NJË ANALIZË TË TREGUT

Që një biznes online të jetë i suksesshëm, ai duhet të ofrojë diçka që i nevojitet tregut. Për të identifikuar këto nevoja, duhet t'i përgjigjeni disa nga pyetjet e mëposhtme:

- Çfarë dëshironi të arrini? Pse po filloni një biznes?
- Çfarë po ndodh në industri dhe treg? A ka nevojë për produktet/shërbimet tuaja dhe nëse po, kush ka nevojë për to?
- A do të pranohet produkti dhe/ose shërbimi nga tregu?
- Çfarë është ajo që do t'ju dallojë nga pjesa tjetër e bizneseve në treg?



## HAPI 2: KRIJONI NJË PLAN BIZNESI

Plani i biznesit tregon se si kompania do të arrijë qëllimet e përcaktuara dhe do të punojë drejt arritjes së misionit. Një plan biznesi përshkruan qartë se si një biznes mund të tregtojë produktet e tij për të gjeneruar fitim dhe për të qenë tërheqës për investitorët e mundshëm.

## HAPI 3: KRIJIMI I NJË SHOQËRIE TË E-TREGTISË



**Emri i kompanisë** - Zgjidhni emrin e subjektit tuaj juridik dhe kontrolloni nëse i njëjti është i disponueshëm ose ekziston tashmë. Emri i personit juridik nuk duhet të jetë identik me emrin e markës tuaj që dëshironi të krijoni, kështu që emri i personit juridik mund të jetë krejtësisht i ndryshëm nga emri i dyqanit tuaj elektronik.

ARBK rezervon të drejtën të refuzojë regjistrimin e një personi juridik në regjistër nëse titulli i tij është i ngjashëm me një titull tashmë të regjistruar ose të rezervuar, si dhe në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj.



**Format ligjore për hapjen e një shoqërie** - Merrni parasysh të gjitha format ligjore në dispozicion për ju dhe vendosni se cila është më e përshtatshme për ju. Format ligjore që janë në dispozicion kur hapni kompaninë tuaj janë: Biznes Individual, Ortakëri e përgjithshme Ortakëri e Kufizuar dhe Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar. Gjithashtu këtu duhet të zgjidhet kodi i të ardhurave primare të aktivitetit.



**Kontributi themelues** - Kontributi mund të jetë monetar ose jomonetar. Deponimin e parasë në dorë (cash) mund ta bëni menjëherë pas themelimit të shoqërisë, në një llogari bankare të përkohshme ose shtesë, por jo më vonë se një vit pas themelimit të kompanisë. Nëse vendosni për një kontribut themelues jo monetar, një vlerësues i autorizuar duhet të bëjë një vlerësim të artikujve që investoni në kompani (p.sh. kompjuter, telefon, printer, etj.) dhe të përgatisë një raport vlerësimi për themelimin e shoqërisë tregtare.

Me rastin e themelimit të shoqërisë në ARBK, themeluesi/t duhet të deklarojnë mënyrën e sigurimit të investimit themelues, pra nëse ai do të jetë monetar apo jomonetar.



**Deklaratë/marrëveshje për themelimin e e-biznesit tuaj** - Nëse vendosni të themeloni një SH.P.K, në atë rast përgatitet "Deklarata e Themelimit të Shoqërisë", dhe në rastin e themelimit të një SH.P.K përgatitet "Marrëveshja e Themelimit të Shoqërisë".

**Filial** - Nëse e drejtoni biznesin tuaj jashtë vendit ku kompania juaj është e regjistruar, ju duhet të organizoni një zyrë dege. Ju mund të organizoni filialin ose menjëherë me regjistrimin e kompanisë ose në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së kompanisë.



Me rastin e organizimit të filialit është e nevojshme të plotësohet "Vendimi për organizimin e filialit", në të cilin duhet të shënohen: Emri, Selia, Veprimtaria Prioritare dhe Personi i Autorizuar.

**Hapja e një llogarie transaksioni në një bankë** - Në aplikimin për themelimin e një shoqërie tregohet banka ku do të jetë llogaria e transaksionit e kompanisë suaj.



Pas marrjes së vendimit të themelimit nga ARBK, është e nevojshme të vizitoni bankën e përzgjedhur për të nënshkruar dokumentacionin për hapjen e një llogarie transaksioni.

## HAPI 4: THEMELIMI I KOMPANISË

Pas dy deri në tre ditë pune, ARBK nxjerr vendim se biznesi/kompania është themeluar.

## HAPI 5: ZGJEDHJA DHE ZHVILLIMI I NJË ZGJIDHJEJE SOFTUERIKE

Për të ekzistuar e-commerce është e nevojshme të përdoret një aplikacion softuer i bazuar në ueb, përmes të cilit do të mundësohet pagesa elektronike.

Pavarësisht nëse vendosni të krijoni një zgjidhje krejtësisht të re softuerike ose të përdorni disa nga zgjidhjet e gatshme "open source" si WordPress ose Magento, ose nëse i bashkoheni një prej tregjeve lokale online (Marketplaces), paralelisht me regjistrimin e personit juridik, ju mund të shfletoni opsionet dhe të kërkonit oferta për ndërtimin dhe zhvillimin e dyqanit tuaj elektronik, në mënyrë që të kurseni kohë dhe të jeni në gjendje të hapni biznesin tuaj sa më shpejt të jetë e mundur.


## HAPI 6: INTEGRIMI I PROCESORIT TË PAGESAVE

Kur hapni një llogari bankare ose pasi zhvilloni zgjidhjen tuaj softuerike, duhet të paraqisni një kërkesë në bankën tuaj për zbatimin e një terminali virtual POS në dyqanin tuaj elektronik.

Banka kontrollon dhe vlerëson tregtarin elektronik të mundshëm në mënyrë që të parandalojë menjëherë klientët e rremë dhe joserioz që të hapin një dyqan në internet, dhe nëse gjithçka është në rregull, banka dhe tregtari elektronik lidhin një marrëveshje, në të cilën janë të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella, më saktë të rregulluara. E gjithë procedura e kontrollit dhe lidhjes së kontratave kontrollohet nga organizatat ndërkombëtare të kartave për të garantuar një nivel të lartë sigurie gjatë kryerjes së transaksioneve elektronike.

Dokumentacionin e marrë për integrimin e procesorit të pagesave i dorëzoni personit të IT-së që po krijon dyqanin tuaj elektronik me qëllim zbatimin e suksesshëm.

Më shumë informacione për ofertën dhe mundësitë për integrimin e procesorit të pagesave do të mund të shihni në MODULI 2 – Ecommerce4all.mk




# commerce4all

REGIONAL PLATFORM

Project implementator



Project partners



Ky publikim është krijuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Ministrisë Federale Gjermane të Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ekonomik (BMZ). Përmbytja e tij është përgjegjësi e vetme e STIKK dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e BE-së ose të Ministrisë Federale të Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ekonomik (BMZ).